



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.10/7 prot

Datë 19.01.2024

V E N D I M
Nr.74 /2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.01.2024 me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-92229-12-27-2023, me objekt “Blerje kancelari për nevoja të shoqërisë OST Sh.A”, me fond limit 3,000,000.00 (tre milion) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 02.11.2023, nga autoriteti kontraktor Operatori i Sistemit të Transmetimit OST.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë Autostrada Tiranë-Durrës, km 8, Kashar, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST Sh.A) me adresë Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës Km. 9
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit

Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28-12-2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-92229-12-27-2023, me objekt “*Blerje kancelari për nevoja të shoqërisë OST Sh.A*”, me fond limit 3,000,000.00 (tre milion) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 02.11.2023, nga autoriteti kontraktor Operatori i Sistemit të Transmetimit OST.

II.2. Në datën 03.01.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 10/2024 protokollit, e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna

të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës me nr. 19/4 prot., datë 05.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 10/3 prot., datë 08.01.2024, me objekt “Dërgohet vendimi i arsyetuar”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar aktin e trajtimit të ankesës, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka pranuar pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues si më poshtë vijon:

“[...]Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) në lidhje me pretendimet e mësiperme te OE ankimues, iu referua ankesës se operatorit ekonomik, si dhe dokumenteve të tenderit të hartuara nga NJP, ku pasi i shqyrtoi ato me imtësi arriti në konkluzionin si më poshtë vijon:

I. Per sa i perket pjesës së parë të ankesës, ku referohet në kriteret e veçanta, pika 2.3.1 (2.3.4), në lidhje me kundërshtimin e OE ankimues që të paraqiten mostrat, sipas kërkesës, për zërat:

- 1. Hapëse vrimash në letër min 100 flete, me vizore dhe me kontejner për mbetjet e letrës.*
- 2. Dosje Konferencash me kapak, me veshje lëkure, kapëse të fortë metalike, me xhëp të brendshëm dhe me mbajtëse stilolapsi, të zezë.*

KSHA çmon se këto artikuj nuk janë kërkuar në Formularin e specifikimeve teknike, dhe për këtë arsye ato duhen të ndryshohen sipas kërkesës së këtij formulari, duke korrigjuar këtë lapsus.

II. Per sa i perket pretendimeve të tjera të OE ankimues, lidhur me përcaktimet e specifikimeve teknike të artikujve, KSHA çmon se në ankesën e paraqitur nuk provohet apo vërtetohen se këto përshkrime drejtojnë ofertën ndaj një marke apo prodhuesi të vetëm.

Të gjithë artikujt e cituar nga OE ankimues, kanë një përshkrim të përgjithshëm dhe këto artikuj janë kërkuar nga Autoriteti Kontraktor edhe gjatë viteve të kaluara, ku ka pasur konkurrencë të mjaftueshme nëpërmjet OE të interesuar, ku edhe vetë OE ankimues ka qenë pjesëmarrës.

Sugjerimet e OE ankimues janë të tilla, ku diapazonet e kërkuara janë të ndryshme, here 1 apo 2 apo 3 cm, duke mos mbajtur një standard por duke kërkuar për të ndikuar në specifikime teknike të qarta për të, ku mund të ndikojnë në kufizimin apo orientim ndaj një malli të caktuar.

Heqja apo ndryshimi i elementëve të specifikimeve teknike, të kërkuara nga OE ankimues, sjellin uljen e cilësisë së mallrave të kërkuara objekt prokurimi.

Përcaktimi i tërësisë se elementëve më të rëndësishëm, nga ana e Autoritetit Kontraktor, ka për qëllim marrjen e produktit me cilësinë e/kërkuar, për të cilat nuk rezulton që te krijohen kufizime te mallrave ne treg por qe gjendet lehtësisht.

Përshkrimi i mallrave objekt prokurimi është bërë në mënyre te tille qe te jete i nje cilësie të larte. Referuar pikës 3, të nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", përcaktohet se: "Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontraten;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve:

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate.

Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Në zbatim të dispozitës së mësipërme, Autoriteti Kontraktor ka përshkruar në mënyrë të hollësishme çdo artikull, sipas nevojave dhe diskrecionit të tij, duke respektuar parimin e mosdiskriminimit dhe duke mos përcaktuar asnjë markë.

Ndërsa, referuar pikës 2, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, përcaktohet se:

"Per mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara."

Gjithashtu, në fund të shtojcës 5 "Formulari i specifikimeve teknike", është bërë shënimi:

"Ne respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet "markë" përfshihet termi "ose ekuivalenti i tij/saj"."

Nga sa me sipër, KSHA çmon se ankesa nuk mund të pranohet në lidhje me këto pretendime të OE.

III. Në lidhje me pretendimin e tretë të OE ankimes, për vendosjen e kritereve të kualifikimit, KSHA konstaton se këto pretendime nuk janë të bazuara, pasi edhe në ankesën e paraqitur nuk cilësohet si cili kriter është i tepërt apo i gabuar, por edhe në një vështrim të përgjithshëm të tyre, ato rezultojnë brenda parashikimeve të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, duke lënë mundësi për një konkurrencë të gjerë të operatorëve ekonomikë të interesuar për këtë procedurë prokurimi.

Si përfundim, gjykojmë se ankesa e paraqitur duhet pranuar pjesërisht.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit me arsyetimin, se *“Për artikullin hapëse vrimash në letër min 100 fletë, me vizore dhe me kontenier për mbetjet e letrës dhe dosje konferencash me kapak, me veshje lëkure, kapëse të fortë metalike, me xhep të brendshëm dhe me mbajtëse stilolapsi të zezë, për të cilat kërkohet të paraqiten mostra në ditën dhe orën e përcaktuar të zhvillimit të tenderit, vumë re se këto dy artikuj nuk janë të pasqyruar në formularin e sasisë dhe grafikut të lëvrimit. Kërkojmë nga AK modifikimin e pikës 2.3.1 në kriteret e veçanta të kualifikimit dhe heqjen nga lista të mostrave që kërkohen për dorëzim për artikujt e mësipërm, pasi nuk janë pjesë e artikujve që kërkohen për zhvillimin e kësaj procedure”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1 Nëpërmjet shkresës me nr. 19/4 prot., datë 05.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 10/3 prot., datë 08.01.2024, me objekt “Dërgohet vendimi i arsyetuar”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar aktin e trajtimit të ankesës. Konstatohet se autoriteti kontraktor ka pranuar pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues si më poshtë vijon:

“[...]Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) në lidhje me pretendimet e mësipërme të OE ankimues, iu referua ankesës së operatorit ekonomik, si dhe dokumenteve të tenderit të hartuara nga NJP, ku pasi i shqyrtoi ato me imtësi arriti në konkluzionin si më poshtë vijon:

I. Per sa i perket pjesës së parë të ankesës, ku referohet në kriteret e veçanta, pika 2.3.1 (2.3.4), në lidhje me kundërshtimin e OE ankimues që të paraqiten mostrat, sipas kërkesës, për zërat:

- 1. Hapëse vrimash në letër min 100 flete, me vizore dhe me kontejner për mbetjet e letrës.*
- 2. Dosje Konferencash me kapak, me veshje lëkure, kapëse të fortë metalike, me xhep të brendshëm dhe me mbajtëse stilolapsi, të zezë.*

KSHA çmon se këto artikuj nuk janë kërkuar në Formularin e specifikimeve teknike, dhe për këtë arsye ato duhen të ndryshohen sipas kërkesës së këtij formulari, duke korrigjuar këtë lapsus [...]”.

III.1.2 Në shtojcën 7 “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes kualifikimit” pika 2.3.4 të dokumentave të tenderit përcaktohet:

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të cilesojë se mallrat e ofruara prej tij, janë të reja dhe jo të rikonstruara si dhe të një cilësie të lartë të cilat të garantojnë mirëfunksionimin e tyre. Operatori ekonomik ofertues, ditën dhe orën e caktuar për zhvillimin e tenderit, duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor nga një mostër sipas listës së mëposhtme:

- 1. Stilolaps i thjeshtë me majë 0.7 mm, me kapak, me majë të hollë nikeli argjendi, trup cilindrik, me bojë blu.*

2. Stilolaps rrollerball, me majë konike metalike, cilësorë, me kapak, gjerësia e vijës 0.6 mm, me ngjyrë blu, kundër avullimit të bojës.
3. Hapëse vrimash në letër min 100 fletë, me vizore dhe me kontenier për mbetjet e letrës.
4. Dosje A4 me mekanizëm me kuti me përmasa 6x32x29 cm, e plastifikuar, kutia me kokrriza në prekje, me unaze për tërheqjen e dosjes.
5. Dosje A4 me mekanizëm me kuti me përmasa 8,5x32x29 cm, e plastifikuar, kutia me kokrriza në prekje, me unaze për tërheqjen e dosjes.
6. Dosje Konferencash me kapak, me veshje lëkure, kapëse të fortë metalike, me xhep të brendshëm dhe me mbajtëse stilolapsi, të zezë.
7. Letër A4 80 g/m2 e bardhë (Kuti – 5 rizme) Premium Quality.

Mosparaqitja e mostrave ne vendin, ditën dhe oren e caktuar per hapjen e ofertave, konsiderohen si kusht per skualifikim.

III.1.3. Në pikat 1 dhe 4 të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin, vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.1.4. Në pikën 6 të nenit 40 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar përcaktohet se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose. [...]*

III.1.5 Komisioni gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me pretendimin më sipër të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterit të veçantë të kualifikimit të sipërpërmendur, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, konkretisht për artikullin hapëse vrimash në letër min 100 fletë, me vizore dhe me kontejner për mbetjet e letrës dhe dosje konferencash me kapak, me veshje lëkure, kapëse të fortë metalike, me xhep të brendshëm dhe me mbajtëse stilolapsi të zezë, për të cilat kërkohet të paraqiten mostra në ditën dhe orën e përcaktuar të zhvillimit të tenderit, ky pretendim është pranuar pjesërisht nga autoriteti kontraktor me arsyetimin se “*Duke qenë se këto artikuj nuk janë kërkuar në formularin e specifikimeve teknike dhe për këtë arsye ato duhen të ndryshohen sipas kërkesës së këtij formulari, duke korrigjuar këtë lapsus*”. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK rezultojnë, se operatori ekonomik kërkon: “*heqjen nga lista e mostrave që kërkohen për dorëzim për artikujt e mësipërm, duke qenë se nuk janë pjesë e artikujve që kërkohen për zhvillimin e kësaj procedure*”. Nga verifikimi i dokumenteve standarde të tenderit rezultojnë, se artikujt “hapëse vrimash në letër min 100 fletë, me vizore dhe me kontejner për mbetjet e letrës dhe dosje konferencash me kapak, me veshje lëkure, kapëse të fortë metalike, me xhep të brendshëm dhe me mbajtëse stilolapsi të zezë nuk janë parashikuar në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”. Referuar shkresës nr. 19/4 prot., datë 05.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 10/3 prot., datë 08.01.2024, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka pranuar pjesërisht pretendimin e operatorit ekonomik ankimues duke vendosur se : [...]*KSHA çmon se këto artikuj nuk janë kërkuar në Formularin e specifikimeve teknike, dhe për këtë arsye ato duhen të ndryshohen sipas kërkesës së këtij formulari, duke korrigjuar këtë lapsus*. Referuar shtojcës 7 pika 2.3.4 përcaktohet se për artikujt *Hapëse vrimash në letër min 100 fletë, me vizore dhe me kontejner për mbetjet e letrës dhe Dosje Konferencash me kapak, me veshje lëkure, kapëse të fortë metalike, me xhep të brendshëm dhe me mbajtëse stilolapsi, të zezë kërkohen që të paraqiten mostra ditën dhe orën e caktuar për hapjen e ofertave*.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77, pika 1, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik. Në rastin konkret

KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kriteret të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësisimit të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave. Në këto kushte, KPP gjykon, se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mostrave është në përputhje me nenin 40 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, por kërkesa për dorëzimin e mostrave për artikullin *Hapëse vrimash në letër min 100 fletë, me vizore dhe me kontenier për mbetjet e letrës*, si dhe artikullin *Dosje Konferencash me kapak, me veshje lëkure, kapëse të fortë metalike, me xhep të brendshëm dhe me mbajtëse stilolapsi, të zezë* është një kërkesë e ekzagjeruar dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Komisioni gjykon, se për artikujt e sipërpërmendur nuk është e nevojshme paraqitja e mostrave, pasi kriteri i mësispërm nuk është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit të sipërcituar sipas konstatimeve të mësipërme.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*Infosoft Office*” SHPK mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit me arsyetimin se: “*Për artikullin nr. 12 AK ka kërkuar dosje kartoni e plastifikuar A4, gjerësia min 3 cm, me llastik të gjerë min 1.2 cm*”. Kërkesa që dosja të ketë llastik të gjerë min 1.2 cm është një kërkesë e ekzagjeruar dhe nuk ndikon në funksionalitetin e dosjes. Është e mjaftueshme që llastiku të kryejë funksionin e mbylljes së dosjes dhe këtë funksion e kryen edhe një llastik normal. Kërkojmë që të hiqet kërkesa “*me llastik të gjerë min 1,2 cm*”, për artikujt nr. 13 *Dosje A4 me mekanizëm me kuti me përmasa 6x32x29 cm, e plastifikuar, kutia me kokrriza në prekje, me unaze për tërheqjen e dosjes, specifikimet kaq të detajuara të vendosura nga AK të cojnë drejt një produkti/marke të caktuar duke kufizuar në mënyrë të ndjeshme konkurrencën. Përmasat që janë vendosur për dosjen janë shumë fikse dhe është e nevojshme që të vendoset një tolerancë +/-*. Gjithashtu kërkesa që dosja të jetë e plastifikuar dhe akoma më tepër me kokrriza në prekje janë kërkesa të ekzagjeruara dhe nuk ndikojnë aspak në funksionalitetin e dosjes.

Për artikullin nr. 14 AK ka kërkuar, *Dosje A4 me mekanizëm me kuti me përmasa 8,5x32x29 cm, e plastifikuar, kutia me kokrriza në prekje, me unaze për tërheqjen e dosjes.*” Specifikime kaq të detajuara të vendosura nga AK të cojnë drejt një produkti/marke të caktuara, duke kufizuar në mënyrë të ndjeshme konkurrencën. Përmasat e vendosura për dosjen janë shumë fikse dhe është e nevojshme që të vendoset një tolerancë +/-. Gjithashtu, kërkesat që dosja të jetë e plastifikuar dhe akoma më tepër që të jetë me kokrriza në prekje janë kërkesa shumë të ekzagjeruara dhe nuk ndikojnë aspak në funksionalitetin e dosjes [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren,

III.2.1 Në dokumentet e tenderit, Shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike” autoriteti kontraktor ka parashikuar specifikimet teknike si vijon:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Binder Clips 15 mm (kuti me 12 copë).	kuti	100
2	Binder Clips 19 mm (kuti me 12 copë).	kuti	100
3	Binder Clips 25 mm (kuti me 12 copë).	kuti	100
4	Binder Clips 32 mm (kuti me 12 copë).	kuti	100
5	Binder Clips 41 mm (kuti me 12 copë).	kuti	100
6	Binder Clips 51 mm (kuti me 12 copë).	kuti	100
7	Blloqe pune A5, minimumi 80 flet me vija.	copë	300
8	Bojë vule 30 ml blu.	copë	20
9	CD-RË 700 MB me kapak (pako me 10 copë).	pako	100
10	Dosje A4, me llastik , me karton të trashë min 450 gr.	copë	500
11	Dosje Bene plastike, me dy vrima, me kapëse, me kapak plastik 90 -110 mic.	copë	200
12	Dosje kartoni e plastifikuar A4, gjerësia min 3 cm, me llastik të gjerë min 1,2 cm.	copë	200
13	Dosje A4 me mekanizëm me kuti me përmasa 6x32x29 cm, e plastifikuar, kutia me kokrriza në prekje, me unaze për tërheqjen e dosjes.	copë	700
14	Dosje A4 me mekanizëm me kuti me përmasa 8x5x32x29 cm, e plastifikuar, kutia me kokrriza në prekje, me unaze për tërheqjen e dosjes.	copë	1300
15	Dosje me 20 qese plastike, kapak plastik i fortë, zarfi plastik duhet të jetë min 40 - 45 mic.	copë	100
16	Dosje me 30 qese plastike, kapak plastik i fortë, zarfi plastik duhet të jetë min 40 - 45 mic.	copë	200
17	Dosje Plastike me buton 35cm X 25cm me gjerësi 15cm, me unaze plastike për tërheqjen e dosjesh, me xhep për etikete.	copë	100
18	DVD me kapak.	copë	100
19	Evidenciator cilësor, me majë të pjerrët dhe me gjerësi min 5 mm, (pako me 4 cope).	pako	300
20	Flash Memory, 3.0, 32 GB.	copë	50
21	Flash Memory, 3.0, 64 GB.	copë	50
22	Gërshërë për letër min 21 cm, me doreza plastike.	copë	150
23	Goma për laps.	copë	300
24	Hapëse vrimash në letër min 25 fletë, me vizore dhe me kontenier për mbetjet e letrës.	copë	30

25	Hapëse vrimash në letër min 50 fletë, me vizore dhe me kontenier për mbetjet e letrës.	copë	10
26	Heqëse telash.	copë	200
27	Korrektor me shirit min 5 mm X 8 m.	copë	200
28	Korrektor stilo, me majë sferike metalike, me kapak, min 7 ml.	copë	400
29	Kuti kartoni arkive me kapak te përthyer me hapësirë te brendshme për dosje A4 përmasa e kutisë jo më pak se (L 40 x H 20 x D 29 cm)	copë	1500
30	Lapsa shënimesh i thjeshtë.	copë	1000
31	Letër A1 Rotolo Plotter 90 g/m2 e bardhë, me përmasa 914 cm x 50 m. Premium Quality.	rulon	25
32	Letër A4 80 g/m2 e bardhë (Kuti – 5 rizme) Premium Quality.	kuti	700
33	Libër dorëzimi poste.	copë	50
34	Libër protokolli me 100 fletë.	copë	20
35	Makinë stapler (qepje) dok. 23/10, me mekanizëm metalik.	copë	5
36	Makinë stapler (qepje) dok. 23/24, me mekanizëm metalik.	copë	5
37	Makinë stapler (qepje) dok. 24/6, me mekanizëm metalik, min 18 cm, me dy mënyra kapje.	copë	200
38	Makinë llogaritëse tavoline me 12 shifra, ekran të lëvizshëm, me dy mënyra karikimi, të ketë të gjitha funksionet ekonomike.	copë	20
39	Marker permanent (pako me 4 copë)	pako	100
40	Mbajtëse dokumentash horizontale me tre kate metalike per tavolin	copë	200
41	Mina, me përmasa 0.5 mm, 12 pcs HB.	copë	100
42	Mina, me përmasa 0.7 mm, 12 pcs HB.	copë	100
43	Ngjites stik, me peshë min 20 gr.	copë	100
44	Notes, me përmasa 125 mm x 75 mm, pesha min 75 gr, me 100 fletë pakoja.	copë	500
45	Notes, me përmasa 45 mm x 12 mm, me 100 fletë, plastike me shumë ngjyra.	copë	500
46	Notes, me përmasa 76 mm x 76mm, pesha min 75 gr, me 100 fletë pakoja.	copë	500
47	Paper Clip 33 mm (pako me 100 copë).	pako	500
48	Paper Clip 50 mm (pako me 100 copë).	pako	200
49	Portamina me majë 0.5 mm, me gominë në mbajtësen e lapsit, turp plastik, me gomë	copë	100
50	Portamina me majë 0.7 mm, me gominë në mbajtësen e lapsit, turp plastik, me gomë	copë	200
51	Qese A4 me vrima anash, min 60 mic, prekje me kokrriza (pako me 100 fije).	pako	600
52	Skoc ngjites i tejdukshëm, me përmasa min 15 x 10.	copë	200
53	Skoc ngjites i tejdukshëm, për ambalazh.	copë	50
54	Stilo gel, me majë 0.7 mm, me kapje metalike tek kapak, me trup të gomuar, ngjyre blu	copë	250
55	Stilolaps i thjeshte me majë 0.7 mm, me kapak, me majë të hollë nikeli argjendi, trup cilindrik, me bojë blu.	copë	2500

56	Stilolaps rrollerball, me majë konike metalike, cilësorë, me kapak, gjerësia e vijës 0.6 mm, me ngjyrë blu, kundër avullimit të bojës.	copë	500
57	Tampon vule	copë	10
58	Tela stapler 23/10, (kutia me 1000 pcs).	kuti	30
59	Tela stapler 23/24, (kutia me 1000 pcs).	kuti	20
60	Tela stapler 24/6, (kutia me 1000 pcs).	kuti	1000
61	Vizore plastike 30 cm.	copë	50
62	Zarf letre, me përmasa 23 cm x 33 cm.	copë	8000
63	Zarf letre, me përmasa 30 cm x 40 cm.	copë	1500
64	Zarf letre, me përmasa 11 cm x 23 cm.	copë	1000
65	Zarf plastike me buton A 4, min 130 mic.	copë	500
66	Zarf me ajër 32 x 44 K7	copë	500

Letra A4, të jetë ekselente.

- * Të jetë CIE. Bardhësia: min 166 – 172 dhe pa lustër.
- * Të jetë shumë përdorimshe, (fotokopje, printer, fax).
- * Peshë e një fije të jetë min 80 gr/m² dhe një rizme min 500 fije x A4. Lagështira: min 3.5 - 4.5 %. Trashësia: min 104 – 112 µm. Drita: min 94%. Shkëlqimi: min 101 – 114 %.
- * Të mos jetë e ricikluar.
- * Ambalazhimi: letra të ketë mbështjellje kundër lagështirës. Letra të mos bllokohen makinën fotokopjuese apo printerin, fax-in.
- * Të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit. Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit.
- * Të jetë e përshtatshme për printim nga të dyja anët.
- * Të plotësojnë standardet që letra të mbahet për një kohë të gjatë në arkiv, sipas ISO 9706.

Shënime:

- i. Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.
- ii. Kudo në Specifikimet Teknike ku është cituar standard ndërkombëtar, do të pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.

III.2.3 Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” përcaktohet se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një

fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.2.4 Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, 2 Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.

KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike.

Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën.

Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve.

Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj". Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 "Për prokurimin publik" KE, parashikohet se: *"Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim"*. Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" përcaktohet *"Specifikime teknike" janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t'u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t'i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të*

përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”

Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: “*specifikim teknik*” nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit;

Në vendimin e GJED Çëshjta C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “*Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë, që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të parashtrojnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se ligji 162/2020 “Për prokurimin publik” është përafuar pjesërisht edhe me *Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, e ndryshuar*. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): “Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar”. Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor, si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

III.2.5. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i

zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.2.6 Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktet e kërkuara, si dhe të kërkojë që produktet objekt-prokurimi të jenë të cilësisë maksimale. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, konkretisht shtojcës 5 “*Formulari i specifikimeve teknike*” konstaton, se autoriteti kontraktor për artikullin nr. 12 ka kërkuar “*dosje kartoni e plastifikuar A4, gjerësia min 3 cm, me llastik të gjerë min 1.2 cm*”, për artikullin nr. 13 autoriteti kontraktor ka kërkuar “*Dosje A4 me mekanizëm me kuti me përmasa 6x32x29 cm, e plastifikuar, kutia me kokrriza në prekje, me unaze për tërheqjen e dosjes*”, për artikullin nr. 14 autoriteti kontraktor ka kërkuar, *Dosje A4 me mekanizëm me kuti me përmasa 8,5x32x29 cm, e plastifikuar, kutia me kokrriza në prekje, me unaze për tërheqjen e dosjes.*” Referuar shkresës me nr. 19/4 prot., datë 05.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 10/3 prot., datë 08.01.2024, aktit të trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, rezulton, se autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar, se si specifikimet teknike për të cilat ankimuesi ngre pretendime, konkretisht për artikullin 12 “*kërkesa që dosja të ketë llastik të gjerë min 1,2 cm*”, për artikullin me nr. 13, përmasat fikse 6x32x29 të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, si dhe materiali i përcaktuar i plastifikuar me kokrriza në prekje, si dhe për artikullin 14 përmasat e përcaktuara 8,5x32x29 dhe materiali i përcaktuar i plastifikuar me kokrriza në prekje, ndikojnë në funksionalitetin e artikujve objekt -prokurimi, dhe se si modifikimi i këtyre specifikimeve do të cenonte funksionalitetin e tyre.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë specifikime teknike që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin apo shërbimin e kërkuar, por pa përcaktuar specifikime teknike të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit ose cilësinë e shërbimit të kërkuar, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendose kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, apo fikse duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. Komisioni konstaton, se në specifikimet teknike për artikullin nr. 12, autoriteti ka kërkuar që dosja të ketë llastik të gjerë min 1,2 cm, duke detyruar operatorët ekonomikë të interesuar të kufizohen rreth atyre zgjidhjeve që jep autoriteti kontraktor, për artikullin nr. 13 autoriteti ka kërkuar përmasa fikse 6x32x29 cm si dhe materiali i plastifikuar, me kokrriza në prekje. Përcaktimi i përmasave fikse dhe lloji i materialit kufizojnë operatorët ekonomikë të interesuar rreth zgjidhjeve që jep

autoriteti kontraktor, gjithashtu edhe për artikullin 14, përmasat e përcaktuara 8,5x32x29 si dhe materiali i përcaktuar i plastifikuar me kokrriza në prekje, detyron operatorët ekonomikë të interesuar të kufizohen rreth atyre zgjidhjeve që jep autoriteti kontraktor. Komisioni gjykon, se përcaktimi i teknologjive specifike kufizon në mënyrë të panevojshme konkurrencën. Në këto kushte, me qëllim hapjen e diapazonit të artikujve të ofertuar, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor, duhet të modifikojë specifikimet teknike të artikujve objekt – prokurimi, duke i hartuar ato bazuar në funksionalitetin e artikujve që kërkohen, si dhe duke hapur diapazonin e përmasave të kërkuara. Për sa i përket llojit të materialit “me kokrriza në prekje” Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e këtij specifikimi, duke qënë se nuk ndikon në funksionalitetin e artikullit objekt - prokurimi. Në rast se nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të specifikimeve teknike në terma funksionalë, atëherë autoriteti kontraktor në specifikimet teknike duhet të shtojë termin “ekuivalent”, në përputhje me përcaktimet e pikës 4 të nenit 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*Infosoft Office*” SHPK mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit me arsyetimin se: “*Për artikullin nr. 29 AK ka kërkuar Kuti kartoni arkive me kapak te përthyer me hapësirë te brendshme për dosje A4 përmasa e kutisë jo më pak se (L 40 x H 20 x D 29 cm) përmasat e përcaktuara nga ana juaj për këtë artikull janë shumë fikse dhe të çojnë drejt një prodhimi të caktuar, duke kufizuar konkurrencën. Kërkojmë që të caktohet një diapazon i përmasave +- 2 cm*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1 Në dokumentet e tenderit, Shtojcën 5 “*Formulari i Specifikimeve Teknike*” autoriteti kontraktor ka parashikuar specifikimet teknike si vijon:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	<i>Binder Clips 15 mm (kuti me 12 copë).</i>	<i>kuti</i>	<i>100</i>
2	<i>Binder Clips 19 mm (kuti me 12 copë).</i>	<i>kuti</i>	<i>100</i>
3	<i>Binder Clips 25 mm (kuti me 12 copë).</i>	<i>kuti</i>	<i>100</i>
4	<i>Binder Clips 32 mm (kuti me 12 copë).</i>	<i>kuti</i>	<i>100</i>
5	<i>Binder Clips 41 mm (kuti me 12 copë).</i>	<i>kuti</i>	<i>100</i>
6	<i>Binder Clips 51 mm (kuti me 12 copë).</i>	<i>kuti</i>	<i>100</i>
7	<i>Blloqe pune A5, minimumi 80 flet me vija.</i>	<i>copë</i>	<i>300</i>
8	<i>Bojë vule 30 ml blu.</i>	<i>copë</i>	<i>20</i>

9	CD-RË 700 MB me kapak (pako me 10 copë).	pako	100
10	Dosje A4, me llastik , me karton të trashe min 450 gr.	copë	500
11	Dosje Bene plastike, me dy vrima, me kapëse, me kapak plastik 90 -110 mic.	copë	200
12	Dosje kartoni e plastifikuar A4, gjerësia min 3 cm, me llastik të gjerë min 1,2 cm.	copë	200
13	Dosje A4 me mekanizëm me kuti me përmasa 6x32x29 cm, e plastifikuar, kutia me kokrriza në prekje, me unaze për tërheqjen e dosjes.	copë	700
14	Dosje A4 me mekanizëm me kuti me përmasa 8x5x32x29 cm, e plastifikuar, kutia me kokrriza në prekje, me unaze për tërheqjen e dosjes.	copë	1300
15	Dosje me 20 qese plastike, kapak plastik i fortë, zarfi plastik duhet të jetë min 40 - 45 mic.	copë	100
16	Dosje me 30 qese plastike, kapak plastik i fortë, zarfi plastik duhet të jetë min 40 - 45 mic.	copë	200
17	Dosje Plastike me buton 35cm X 25cm me gjerësi 15cm, me unaze plastike per terheqjen e dosjesh, me xhep per etikete.	copë	100
18	DVD me kapak.	copë	100
19	Evidenciator cilësor, me majë të pjerrët dhe me gjerësi min 5 mm, (pako me 4 cope).	pako	300
20	Flash Memory, 3.0, 32 GB.	copë	50
21	Flash Memory, 3.0, 64 GB.	copë	50
22	Gërshërë për letër min 21 cm, me doreza plastike.	copë	150
23	Goma për laps.	copë	300
24	Hapëse vrimash në letër min 25 fletë, me vizore dhe me kontenier për mbetjet e letrës.	copë	30
25	Hapëse vrimash në letër min 50 fletë, me vizore dhe me kontenier për mbetjet e letrës.	copë	10
26	Heqëse telash.	copë	200
27	Korrektor me shirit min 5 mm X 8 m.	copë	200
28	Korrektor stilo, me majë sferike metalike, me kapak, min 7 ml.	copë	400
29	Kuti kartoni arkive me kapak te përthyer me hapësirë te brendshme për dosje A4 përmasa e kutisë jo më pak se (L 40 x H 20 x D 29 cm)	copë	1500
30	Lapsa shënimesh i thjeshtë.	copë	1000
31	Letër A1 Rotolo Plotter 90 g/m2 e bardhë, me përmasa 914 cm x 50 m. Premium Quality.	rulon	25
32	Letër A4 80 g/m2 e bardhë (Kuti – 5 rizme) Premium Quality.	kuti	700
33	Libër dorëzimi poste.	copë	50
34	Libër protokolli me 100 fletë.	copë	20
35	Makine stapler (qepje) dok. 23/10, me mekanizëm metalik.	copë	5
36	Makine stapler (qepje) dok. 23/24, me mekanizëm metalik.	copë	5
37	Makine stapler (qepje) dok. 24/6, me mekanizëm metalik, min 18 cm, me dy mënyra kapje.	copë	200

38	Makinë llogaritëse tavoline me 12 shifra, ekran të lëvizshëm, me dy mënyra karikimi, të ketë të gjitha funksionet ekonomike.	copë	20
39	Marker permanent (pako me 4 copë)	pako	100
40	Mbajtëse dokumentash horizontale me tre kate metalike per tavolin	copë	200
41	Mina, me përmasa 0.5 mm, 12 pcs HB.	copë	100
42	Mina, me përmasa 0.7 mm, 12 pcs HB.	copë	100
43	Ngjitës stik, me peshë min 20 gr.	copë	100
44	Notes, me përmasa 125 mm x 75 mm, pesha min 75 gr, me 100 fletë pakoja.	copë	500
45	Notes, me përmasa 45 mm x 12 mm, me 100 fletë, plastike me shumë ngjyra.	copë	500
46	Notes, me përmasa 76 mm x 76mm, pesha min 75 gr, me 100 fletë pakoja.	copë	500
47	Paper Clip 33 mm (pako me 100 copë).	pako	500
48	Paper Clip 50 mm (pako me 100 copë).	pako	200
49	Portamina me majë 0.5 mm, me gominë në mbajtësen e lapsit, turp plastik, me gomë	copë	100
50	Portamina me majë 0.7 mm, me gominë në mbajtësen e lapsit, turp plastik, me gomë	copë	200
51	Qese A4 me vrima anash, min 60 mic, prekje me kokrriza (pako me 100 fije).	pako	600
52	Skoc ngjitës i tejdukshëm, me përmasa min 15 x 10.	copë	200
53	Skoc ngjitës i tejdukshëm, për ambalazh.	copë	50
54	Stilo gel, me majë 0.7 mm, me kapje metalike tek kapak, me trup të gomuar, ngjyre blu	copë	250
55	Stilolaps i thjeshtë me majë 0.7 mm, me kapak, me majë të hollë nikeli argjendi, trup cilindrik, me bojë blu.	copë	2500
56	Stilolaps rrollerball, me majë konike metalike, cilësorë, me kapak, gjerësia e vijës 0.6 mm, me ngjyrë blu, kundër avullimit të bojës.	copë	500
57	Tampon vule	copë	10
58	Tela stapler 23/10, (kutia me 1000 pcs).	kuti	30
59	Tela stapler 23/24, (kutia me 1000 pcs).	kuti	20
60	Tela stapler 24/6, (kutia me 1000 pcs).	kuti	1000
61	Vizore plastike 30 cm.	copë	50
62	Zarf letre, me përmasa 23 cm x 33 cm.	copë	8000
63	Zarf letre, me përmasa 30 cm x 40 cm.	copë	1500
64	Zarf letre, me përmasa 11 cm x 23 cm.	copë	1000
65	Zarf plastike me buton A 4, min 130 mic.	copë	500
66	Zarf me ajër 32 x 44 K7	copë	500

Letra A4, të jetë ekselente.

★ Të jetë CIE. Bardhësia: min 166 – 172 dhe pa lustër.

★ Të jetë shumë përdorimshe, (fotokopje, printer, fax).

- * Pesha e një fije të jetë min 80 gr/m² dhe një rizme min 500 fije x A4. Lagështira: min 3.5 - 4.5 %. Trashësia: min 104 – 112 µm. Drita: min 94%. Shkëlqimi: min 101 – 114 %.
- * Të mos jetë e ricikluar.
- * Ambalazhimi: letra të ketë mbështjellje kundër lagështirës. Letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin, fax-in.
- * Të qëndrojë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit. Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit.
- * Të jetë e përshtatshme për printim nga të dyja anët.
- * Të plotësojë standardet që letra të mbahet për një kohë të gjatë në arkiv, sipas ISO 9706.

Shënime:

- iii. **Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.**
- iv. **Kudo ne Specifikimet Teknike ku është cituar standard ndërkombëtar, do te pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.**

III.3.2 Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” përcaktohet se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor."

III.3.3 Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, 2 Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.

KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike.

Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën.

Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve.

Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionalë sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton

pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohen në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”*. Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet *“Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”*

Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik”* nënkupton njëherë nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës, paketimin, markimin dhe etiketimin,

përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit;

Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Hollandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “*Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.*”

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të parashtrajnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se ligji 162/2020 “Për prokurimin publik” është përafëruar pjesërisht edhe me *Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, e ndryshuar*. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): “Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar”. Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

III.3.4. KPP-ja gjykon se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.3.5 Komisioni i Prokurimit Publik thekson se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me produktet e kërkuara, si dhe të kërkojë që produktet objekt-prokurimi të jenë të cilësisë maksimale. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes për modifikimin e dokumentave të tenderit Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, konkretisht shtojcës 5 “*Formulari i specifikimeve teknike*” konstaton se autoriteti kontraktor ka kërkuar

për artikullin nr. 29 Kutit kartoni arkive me kapak te përthyer me hapësirë te brendshme për dosje A4 përmasa e kutisë jo më pak se (L 40 x H 20 x D 29 cm).

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë specifikime teknike që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin apo shërbimin e kërkuar, por pa përcaktuar specifikime teknike të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit ose cilësinë e shërbimit të kërkuar, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuzë, apo fikse duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. Komisioni konstaton se në specifikimet teknike për artikullin nr. 29 kutit arkive autoriteti ka kërkuar që përmasat e kutisë të jenë (L 40 x H 20 x D 29 cm) duke detyruar operatorët ekonomikë të interesuar të kufizohen rreth atyre zgjidhjeve që jep autoriteti kontraktor. Referuar shkresës me nr. 19/4 prot., datë 05.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 10/3 prot., datë 08.01.2024 aktit të trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar se si specifikimet teknike për të cilat ankimuesi ngre pretendime, konkretisht për artikullin 29 “kutip arkive nuk ka argumentuar se si përmasat e përcaktuara L 40 x H 20 x D 29 cm ndikojnë në funksionalitetin e artikujve objekt prokurimi, dhe se si modifikimi i këtyre specifikimeve do të cënonte funksionalitetin e tyre. Komisioni gjykon, se përcaktimi i teknologjive specifike kufizon në mënyrë të panevojshme konkurrencën. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë specifikimet teknike të mësipërme, për sa i përket kontestimeve të ngritura nga ana e operatorit ekonomik ankimues dhe të marrë masa për modifikimin e specifikimeve kufizuese dhe përcaktuese, me qëllim hapjen e diapazonit të artikujve të ofertuar, si dhe hapjen e konkurrencës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit me arsyetimin se: *“Për artikullin nr. 29 AK ka kërkuar 37. Makinë stapler qepje dok. 24/6, me mekanizëm metalik, min 18 cm, me dy mënyra kapje. Makinat qepëse 24/6 janë makina për përdorim të përgjithshëm, vetjak dhe është përmasë e telit ajo që kryen funksionin kryesor të qepjes (numrin e fletëve që mund të qepë), të cilën ju e keni përcaktuar që duhet të jetë 24/6. Kërkesa që makina të jetë 18 cm është e ekzagjeruar, pasi të njëjtin funksion kryen dhe një makinë që është më e vogël se 18 cm. Gjatësia e makinës min 18 cm, është shumë e madhe dhe të con drejt një produkti të caktuar. Një makinë dore normale 24/6 është rreth 13 cm. Kërkohet gjithashtu që makina të jetë me dy mënyra kapje. Nuk kuptojmë se si duhet të jenë këto dy mënyra të kësaj dhe çfarë ndryshimi kanë nga njëra tjetra. Ku për më tepër që funksioni i kësaj makine është thjesht*

qepja e disa letrave me njëra tjetrën . Në PV e argumentimit, nuk keni paraqitur asnjë arsye përse këto specifikime janë të domosdoshme. Kërkojmë që të pranohet edhe makinë me gjatësi 13 cm si dhe të hiqet kërkesa me dy mënyra kapje”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1 Në dokumentet e tenderit, Shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike” autoriteti kontraktor ka parashikuar specifikimet teknike si vijon:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Binder Clips 15 mm (kuti me 12 copë).	kuti	100
2	Binder Clips 19 mm (kuti me 12 copë).	kuti	100
3	Binder Clips 25 mm (kuti me 12 copë).	kuti	100
4	Binder Clips 32 mm (kuti me 12 copë).	kuti	100
5	Binder Clips 41 mm (kuti me 12 copë).	kuti	100
6	Binder Clips 51 mm (kuti me 12 copë).	kuti	100
7	Blloqe pune A5, minimumi 80 flet me vija.	copë	300
8	Bojë vule 30 ml blu.	copë	20
9	CD-RË 700 MB me kapak (pako me 10 copë).	pako	100
10	Dosje A4, me llastik , me karton të trashë min 450 gr.	copë	500
11	Dosje Bene plastike, me dy vrima, me kapëse, me kapak plastik 90 -110 mic.	copë	200
12	Dosje kartoni e plastifikuar A4, gjerësia min 3 cm, me llastik të gjerë min 1,2 cm.	copë	200
13	Dosje A4 me mekanizëm me kuti me përmasa 6x32x29 cm, e plastifikuar, kutia me kokrriza në prekje, me unaze për tërheqjen e dosjes.	copë	700
14	Dosje A4 me mekanizëm me kuti me përmasa 8x5x32x29 cm, e plastifikuar, kutia me kokrriza në prekje, me unaze për tërheqjen e dosjes.	copë	1300
15	Dosje me 20 qese plastike, kapak plastik i fortë, zarfi plastik duhet të jetë min 40 - 45 mic.	copë	100
16	Dosje me 30 qese plastike, kapak plastik i fortë, zarfi plastik duhet të jetë min 40 - 45 mic.	copë	200
17	Dosje Plastike me buton 35cm X 25cm me gjerësi 15cm, me unaze plastike per terheqjen e dosjesh, me xhep per etikete.	copë	100
18	DVD me kapak.	copë	100
19	Evidenciator cilësor, me majë të pjerrët dhe me gjerësi min 5 mm, (pako me 4 cope).	pako	300
20	Flash Memory, 3.0, 32 GB.	copë	50

21	Flash Memory, 3.0, 64 GB.	copë	50
22	Gërshërë për letër min 21 cm, me doreza plastike.	copë	150
23	Goma për laps.	copë	300
24	Hapëse vrimash në letër min 25 fletë, me vizore dhe me kontenier për mbetjet e letrës.	copë	30
25	Hapëse vrimash në letër min 50 fletë, me vizore dhe me kontenier për mbetjet e letrës.	copë	10
26	Heqëse telash.	copë	200
27	Korrektor me shirit min 5 mm X 8 m.	copë	200
28	Korrektor stilo, me majë sferike metalike, me kapak, min 7 ml.	copë	400
29	Kuti kartoni arkive me kapak te përthyer me hapësirë te brendshme për dosje A4 përmasa e kutisë jo më pak se (L 40 x H 20 x D 29 cm)	copë	1500
30	Lapsa shënimesh i thjeshtë.	copë	1000
31	Letër A1 Rotolo Plotter 90 g/m2 e bardhë, me përmasa 914 cm x 50 m. Premium Quality.	rulon	25
32	Letër A4 80 g/m2 e bardhë (Kuti – 5 rizme) Premium Quality.	kuti	700
33	Libër dorëzimi poste.	copë	50
34	Libër protokolli me 100 fletë.	copë	20
35	Makine stapler (qepje) dok. 23/10, me mekanizem metalik.	copë	5
36	Makine stapler (qepje) dok. 23/24, me mekanizem metalik.	copë	5
37	Makine stapler (qepje) dok. 24/6, me mekanizem metalik, min 18 cm, me dy mënyra kapje.	copë	200
38	Makinë llogaritëse tavoline me 12 shifra, ekran të lëvizshëm, me dy mënyra karikimi, të ketë të gjitha funksionet ekonomike.	copë	20
39	Marker permanent (pako me 4 copë)	pako	100
40	Mbajtëse dokumentash horizontale me tre kate metalike per tavolin	copë	200
41	Mina, me përmasa 0.5 mm, 12 pcs HB.	copë	100
42	Mina, me përmasa 0.7 mm, 12 pcs HB.	copë	100
43	Ngjitës stik, me peshë min 20 gr.	copë	100
44	Notes, me përmasa 125 mm x 75 mm, pesha min 75 gr, me 100 fletë pakoja.	copë	500
45	Notes, me përmasa 45 mm x 12 mm, me 100 fletë, plastike me shumë ngjyra.	copë	500
46	Notes, me përmasa 76 mm x 76mm, pesha min 75 gr, me 100 fletë pakoja.	copë	500
47	Paper Clip 33 mm (pako me 100 copë).	pako	500
48	Paper Clip 50 mm (pako me 100 copë).	pako	200
49	Portamina me majë 0.5 mm, me gominë në mbajtësen e lapsit, turp plastik, me gomë	copë	100
50	Portamina me majë 0.7 mm, me gominë në mbajtësen e lapsit, turp plastik, me gomë	copë	200
51	Qese A4 me vrima anash, min 60 mic, prekje me kokrriza (pako me 100 fije).	pako	600

52	Skoc ngjitës i tejdukshëm, me përmasa min 15 x 10.	copë	200
53	Skoc ngjitës i tejdukshëm, për ambalazh.	copë	50
54	Stilo gel, me majë 0.7 mm, me kapje metalike tek kapak, me trup të gomuar, ngjyre blu	copë	250
55	Stilolaps i thjeshte me majë 0.7 mm, me kapak, me majë të hollë nikeli argjendi, trup cilindrik, me bojë blu.	copë	2500
56	Stilolaps rrollerball, me majë konike metalike, cilësorë, me kapak, gjerësia e vijës 0.6 mm, me ngjyrë blu, kundër avullimit të bojës.	copë	500
57	Tampon vule	copë	10
58	Tela stapler 23/10, (kutia me 1000 pcs).	kuti	30
59	Tela stapler 23/24, (kutia me 1000 pcs).	kuti	20
60	Tela stapler 24/6, (kutia me 1000 pcs).	kuti	1000
61	Vizore plastike 30 cm.	copë	50
62	Zarf letre, me përmasa 23 cm x 33 cm.	copë	8000
63	Zarf letre, me përmasa 30 cm x 40 cm.	copë	1500
64	Zarf letre, me përmasa 11 cm x 23 cm.	copë	1000
65	Zarf plastike me buton A 4, min 130 mic.	copë	500
66	Zarf me ajër 32 x 44 K7	copë	500

Letra A4, të jetë ekselente.

- * Të jetë CIE. Bardhësia: min 166 – 172 dhe pa lustër.
- * Të jetë shumë përdorimshe, (fotokopje, printer, fax).
- * Pesha e një fije të jetë min 80 gr/m² dhe një rizme min 500 fije x A4. Lagështira: min 3.5 - 4.5 %. Trashësia: min 104 – 112 µm. Drita: min 94%. Shkëlqimi: min 101 – 114 %.
- * Të mos jetë e ricikluar.
- * Ambalazhimi: letra të ketë mbështjellje kundër lagështirës. Letra të mos bllokohet makinën fotokopjuese apo printerin, fax-in.
- * Të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit. Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit.
- * Të jetë e përshtatshme për printim nga të dyja anët.
- * Të plotësojnë standardet që letra të mbahet për një kohë të gjatë në arkiv, sipas ISO 9706.

Shënime:

- v. Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.
- vi. Kudo ne Specifikimet Teknike ku është cituar standard ndërkombëtar, do te pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.

III.4.2 Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” përcaktohet se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të

kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.4.3 Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, 2 Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.

KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike.

Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën.

Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve.

Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj". Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

Gjithashtu, referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 "Për prokurimin publik" KE, parashikohet se: *"Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim"*. Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" përcaktohet *"Specifikime teknike" janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t'u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim,*

për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t'i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”

Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: “*specifikim teknik*” nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit;

Në vendimin e GJED Çëshjta C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “*Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të parashtrojnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se ligji 162/2020 “Për prokurimin publik” është përafëruar pjesërisht edhe me *Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, e ndryshuar*. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): “Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar”. Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me

synim vendosjen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (*qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit*), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor, si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

III.4.4. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.4.5. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë specifikime teknike që garantojnë një cilësi maksimale të produktit. Specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se specifikimet teknike duhet të jenë sa më gjithpërfshirëse, por pa cenuar thelbin e garancisë mbi cilësinë e shërbimit apo të produktit që autoriteti kontraktor kërkon. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike për artikullin nr. 37, ka kërkuar makinë stapler (qepje) objekt - prokurimi si më sipër cituar, ka përcaktuar dok. 24/6, me mekanizëm metalik, min 18 cm, me dy mënyra kapje. KPP konstaton, se ankimuesi në parashtrimet në ankesë nuk është dakord lidhur me përcaktimin e gjatësisë së makinës min 18 cm, pasi pretendon se duhet ndryshohet, pasi një makinë normale dore është 24/6 rreth 13 cm. KPP gjykon, se pretendimet e ankimuesit janë të drejta pasi autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike ka përcaktuar tregues fiks. Në rastin konkret përcaktimi 24/6, me mekanizëm metalik, min 18 cm për artikullin 37 është një specifikim kufizues, duke mos lejuar ofertuesit të ofrojnë artikuj me njësi të ndryshme brenda këtij specifikimi dhe çon në kufizimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë specifikimet teknike të mësipërme, për sa i përket kontestimeve të ngritura nga ana e operatorit ekonomik ankimues dhe të marrë masa për modifikimin e specifikimeve kufizuese dhe përcaktuese, duke parashikuar alternativa, si dhe duke hapur diapazonin, por pa cenuar nivelin minimal të specifikimeve të kërkuar, ashtu sikurse parashikohet edhe në LPP, në funksion të hapjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

III.4.6 Gjithashtu, për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik lidhur me specifikimin e përcaktuar “me dy mënyra kapje” me arsyetimin se “*nuk kuptojmë se si duhet të jenë këto dy mënyra kapje dhe çfarë ndryshimi kanë nga njëra tjetra*”, duke kërkuar që të hiqet kërkesa “*me dy mënyra kapje*”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ndodhemi para kërkimit për sqarime lidhur me çfarë është kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt - ankimi. Në rastin konkret, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik në ankesë ka shtruar në formën e pyetjeve paqartësitë e tij, si dhe kërkon të specifikohen

çfarë nënkuptojnë mënyrat e kapjes së makinës stapler (qepje) e artikullit të sipërcituar si dhe ngre pretendime për heqjen e specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon , se është në të drejtën e autoritetit kontraktor hartimi i specifikimeve teknike që duhet të plotësojnë punët, mallrat apo shërbimet objekt - prokurimi, për sa kohë që respektohen kushtet e qartësisë, proporcionalitetit të tyre me objektin e prokurimit, dhe janë përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. Autoriteti kontraktor, në cilësinë e institucionit të specializuar për hartimin e këtyre specifikimeve, të japë sqarimet përkatëse në përputhje me nenin 75 të ligjit “Për prokurimin publik”, si dhe t’i publikojë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në mënyrë që të bëhen të njohura për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.5 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*Infosoft Office*” SHPK mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit me arsyetimin se: “*Për artikullin nr. 44 AK ka kërkuar Notes, me përmasa 125 mm x 75 mm, pesha min 75 gr, me 100 fletë pakoja “, përmasat 125 mm x 75 mm të përcaktuara në milimetra, janë përmas afikse të cilat kufizojnë në mënyrë të ndjeshme konkurrencën. Kërkojmë që të përcaktoni një diapazon +- 5 mm. Gjithashtu, kërkesa që pesha të jetë min 75 gr është një kërkesë shumë e ekzagjeruar dhe e panevojshme, e cila nuk ndikon në funksionalitet., për artikullin nr. 45 AK ka kërkuar Notes, me përmasa 45 mm x 12 mm, me 100 fletë, plastike me shumë ngjyra, Përmasat 76 mm x 76 mm të përcaktuara në milimetra, janë përmasa fikse të cilat kufizojnë në mënyrë të ndjeshme konkurrencën. Kërkojmë që të përcaktoni një diapazon +- 2 mm. Për artikullin nr. 46 AK ka kërkuar Notes, me përmasa 76 mm x 76mm, pesha min 75 gr, me 100 fletë pakoja. Përmasat 76 mmx 76 mm të përcaktuara në milimetra janë përmasa fikse të cilat kufizojnë në mënyrë të ndjeshme konkurrencën. Gjithashtu, kërkesa që pesha të jetë 75 gr është një kërkesë shumë e ekzagjeruar dhe e panevojshme, e cila nuk ndikon në funksionalitet. Për këtë arsye kërkojmë që të hiqet “pesha min 75 gr”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.5.1 Në dokumentet e tenderit, Shtojcën 5 “*Formulari i Specifikimeve Teknike*” autoriteti kontraktor ka parashikuar specifikimet teknike si vijon:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	<i>Binder Clips 15 mm (kuti me 12 copë).</i>	<i>kuti</i>	<i>100</i>
2	<i>Binder Clips 19 mm (kuti me 12 copë).</i>	<i>kuti</i>	<i>100</i>
3	<i>Binder Clips 25 mm (kuti me 12 copë).</i>	<i>kuti</i>	<i>100</i>
4	<i>Binder Clips 32 mm (kuti me 12 copë).</i>	<i>kuti</i>	<i>100</i>

5	<i>Binder Clips 41 mm (kuti me 12 copë).</i>	<i>kuti</i>	<i>100</i>
6	<i>Binder Clips 51 mm (kuti me 12 copë).</i>	<i>kuti</i>	<i>100</i>
7	<i>Blloqe pune A5, minimumi 80 flet me vija.</i>	<i>copë</i>	<i>300</i>
8	<i>Bojë vule 30 ml blu.</i>	<i>copë</i>	<i>20</i>
9	<i>CD-RË 700 MB me kapak (pako me 10 copë).</i>	<i>pako</i>	<i>100</i>
10	<i>Dosje A4, me llastik , me karton të trashë min 450 gr.</i>	<i>copë</i>	<i>500</i>
11	<i>Dosje Bene plastike, me dy vrima, me kapëse, me kapak plastik 90 -110 mic.</i>	<i>copë</i>	<i>200</i>
12	<i>Dosje kartoni e plastifikuar A4, gjerësia min 3 cm, me llastik të gjerë min 1,2 cm.</i>	<i>copë</i>	<i>200</i>
13	<i>Dosje A4 me mekanizëm me kuti me përmasa 6x32x29 cm, e plastifikuar, kutia me kokrriza në prekje, me unaze për tërheqjen e dosjes.</i>	<i>copë</i>	<i>700</i>
14	<i>Dosje A4 me mekanizëm me kuti me përmasa 8x5x32x29 cm, e plastifikuar, kutia me kokrriza në prekje, me unaze për tërheqjen e dosjes.</i>	<i>copë</i>	<i>1300</i>
15	<i>Dosje me 20 qese plastike, kapak plastik i fortë, zarfi plastik duhet të jetë min 40 - 45 mic.</i>	<i>copë</i>	<i>100</i>
16	<i>Dosje me 30 qese plastike, kapak plastik i fortë, zarfi plastik duhet të jetë min 40 - 45 mic.</i>	<i>copë</i>	<i>200</i>
17	<i>Dosje Plastike me buton 35cm X 25cm me gjerësi 15cm, me unaze plastike per tërheqjen e dosjesh, me xhep per etikete.</i>	<i>copë</i>	<i>100</i>
18	<i>DVD me kapak.</i>	<i>copë</i>	<i>100</i>
19	<i>Evidenciator cilësor, me majë të pjerrët dhe me gjerësi min 5 mm, (pako me 4 cope).</i>	<i>pako</i>	<i>300</i>
20	<i>Flash Memory, 3.0, 32 GB.</i>	<i>copë</i>	<i>50</i>
21	<i>Flash Memory, 3.0, 64 GB.</i>	<i>copë</i>	<i>50</i>
22	<i>Gërshërë për letër min 21 cm, me doreza plastike.</i>	<i>copë</i>	<i>150</i>
23	<i>Goma për laps.</i>	<i>copë</i>	<i>300</i>
24	<i>Hapëse vrimash në letër min 25 fletë, me vizore dhe me kontenier për mbetjet e letrës.</i>	<i>copë</i>	<i>30</i>
25	<i>Hapëse vrimash në letër min 50 fletë, me vizore dhe me kontenier për mbetjet e letrës.</i>	<i>copë</i>	<i>10</i>
26	<i>Heqëse telash.</i>	<i>copë</i>	<i>200</i>
27	<i>Korrektor me shirit min 5 mm X 8 m.</i>	<i>copë</i>	<i>200</i>
28	<i>Korrektor stilo, me majë sferike metalike, me kapak, min 7 ml.</i>	<i>copë</i>	<i>400</i>
29	<i>Kuti kartoni arkive me kapak te përthyer me hapësirë te brendshme për dosje A4 përmasa e kutisë jo më pak se (L 40 x H 20 x D 29 cm)</i>	<i>copë</i>	<i>1500</i>
30	<i>Lapsa shënimesh i thjeshtë.</i>	<i>copë</i>	<i>1000</i>
31	<i>Letër A1 Rotolo Plotter 90 g/m2 e bardhë, me përmasa 914 cm x 50 m. Premium Quality.</i>	<i>rulon</i>	<i>25</i>
32	<i>Letër A4 80 g/m2 e bardhë (Kuti – 5 rizme) Premium Quality.</i>	<i>kuti</i>	<i>700</i>
33	<i>Libër dorëzimi poste.</i>	<i>copë</i>	<i>50</i>
34	<i>Libër protokolli me 100 fletë.</i>	<i>copë</i>	<i>20</i>
35	<i>Makine stapler (qepje) dok. 23/10, me mekanizëm metalik.</i>	<i>copë</i>	<i>5</i>

36	Makine stapler (qepje) dok. 23/24, me mekanizem metalik.	copë	5
37	Makine stapler (qepje) dok. 24/6, me mekanizëm metalik, min 18 cm, me dy mënyra kapje.	copë	200
38	Makinë llogaritëse tavoline me 12 shifra, ekran të lëvizshëm, me dy mënyra karikimi, të ketë të gjitha funksionet ekonomike.	copë	20
39	Marker permanent (pako me 4 copë)	pako	100
40	Mbajtëse dokumentash horizontale me tre kate metalike per tavolin	copë	200
41	Mina, me përmasa 0.5 mm, 12 pcs HB.	copë	100
42	Mina, me përmasa 0.7 mm, 12 pcs HB.	copë	100
43	Ngjitës stik, me peshë min 20 gr.	copë	100
44	Notes, me përmasa 125 mm x 75 mm, pesha min 75 gr, me 100 fletë pakoja.	copë	500
45	Notes, me përmasa 45 mm x 12 mm, me 100 fletë, plastike me shumë ngjyra.	copë	500
46	Notes, me përmasa 76 mm x 76mm, pesha min 75 gr, me 100 fletë pakoja.	copë	500
47	Paper Clip 33 mm (pako me 100 copë).	pako	500
48	Paper Clip 50 mm (pako me 100 copë).	pako	200
49	Portamina me majë 0.5 mm, me gominë në mbajtësen e lapsit, turp plastik, me gomë	copë	100
50	Portamina me majë 0.7 mm, me gominë në mbajtësen e lapsit, turp plastik, me gomë	copë	200
51	Qese A4 me vrima anash, min 60 mic, prekje me kokrriza (pako me 100 fije).	pako	600
52	Skoc ngjitës i tejdukshëm, me përmasa min 15 x 10.	copë	200
53	Skoc ngjitës i tejdukshëm, për ambalazh.	copë	50
54	Stilo gel, me majë 0.7 mm, me kapje metalike tek kapak, me trup të gomuar, ngjyre blu	copë	250
55	Stilolaps i thjeshte me majë 0.7 mm, me kapak, me majë të hollë nikeli argjendi, trup cilindrik, me bojë blu.	copë	2500
56	Stilolaps rrollerball, me majë konike metalike, cilësorë, me kapak, gjerësia e vijës 0.6 mm, me ngjyrë blu, kundër avullimit të bojës.	copë	500
57	Tampon vule	copë	10
58	Tela stapler 23/10, (kutia me 1000 pcs).	kuti	30
59	Tela stapler 23/24, (kutia me 1000 pcs).	kuti	20
60	Tela stapler 24/6, (kutia me 1000 pcs).	kuti	1000
61	Vizore plastike 30 cm.	copë	50
62	Zarf letre, me përmasa 23 cm x 33 cm.	copë	8000
63	Zarf letre, me përmasa 30 cm x 40 cm.	copë	1500
64	Zarf letre, me përmasa 11 cm x 23 cm.	copë	1000
65	Zarf plastike me buton A 4, min 130 mic.	copë	500
66	Zarf me ajër 32 x 44 K7	copë	500

Letra A4, të jetë ekselente.

- * Të jetë CIE. Bardhësia: min 166 – 172 dhe pa lustër.
- * Të jetë shumë përdorimshe, (fotokopje, printer, fax).
- * Peshë e një fije të jetë min 80 gr/m² dhe një rizme min 500 fije x A4. Lagështira: min 3.5 - 4.5 %. Trashësia: min 104 – 112 µm. Drita: min 94%. Shkëlqimi: min 101 – 114 %.
- * Të mos jetë e ricikluar.
- * Ambalazhimi: letra të ketë mbështjellje kundër lagështirës. Letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin, fax-in.
- * Të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit. Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit.
- * Të jetë e përshtatshme për printim nga të dyja anët.
- * Të plotësojnë standardet që letra të mbahet për një kohë të gjatë në arkiv, sipas ISO 9706.

Shënime:

- vii. ***Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.***
- viii. ***Kudo ne Specifikimet Teknike ku është cituar standard ndërkombëtar, do te pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.***

III.5.2 Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” përcaktohet se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor."

III.5.3 Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, 2 Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.

KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike.

Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën.

Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve.

Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionalë sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton

pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

Gjithashtu, referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”*. Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet *“Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”*

Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik”* nënkupton njëherë nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës, paketimin, markimin dhe etiketimin,

përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit;

Në vendimin e GJED, Çëshjta C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “*Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.*”

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të parashtrojnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se ligji 162/2020 “Për prokurimin publik” është përafëruar pjesërisht edhe me *Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, e ndryshuar*. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): “Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar”. Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor, si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

III.5.4. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

III.5.5. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë specifikime teknike që garantojnë një cilësi maksimale të produktit. Specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se specifikimet teknike duhet të jenë sa më gjithpërfshirëse, por pa

cenuar thelbin e garancisë mbi cilësinë e shërbimit apo të produktit që autoriteti kontraktor kërkon. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike për artikullin nr. 44, autoriteti kontraktor ka kërkuar Notes, me përmasa 125 mm x 75 mm, pesha min 75 gr, me 100 fletë pakoja, për artikullin nr. 45 ka kërkuar Notes, me përmasa 45 mm x 12 mm, me 100 fletë, plastike me shumë ngjyra, për artikullin nr. 46 Notes, autoriteti kontraktor ka kërkuar me përmasa 76 mm x 76mm, pesha min 75 gr, me 100 fletë pakoja. Komisioni konstaton, se autoriteti ka përcaktuar përmasa fikse për artikullin nr. 44 konkretisht 125 mm x 75 mm, si dhe pesha min 75 gr, për artikullin nr. 45, përmasat 45 mm x 12 mm, dhe për artikullin nr. 46 autoriteti ka kërkuar 76 mm x 76 mm dhe si pesha “75 min gr”. KPP konstaton, se ankimuesi në parashtrimet në ankesë nuk është dakord lidhur me përmasat fikse të përcaktuara nga autoriteti kontraktor si dhe lidhur me peshën e përcaktuar për sa i përket artikullit “notes”, gjykon se pretendimet e ankimuesit janë të drejta pasi autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike ka përcaktuar tregues fiks. Në rastin konkret, përcaktimi i përmasave dhe peshës për artikullin 44, 45 dhe 46 është një specifikim kufizues, duke mos lejuar ofertuesit të ofrojnë artikuj me njësi të ndryshme brenda këtij specifikimi dhe çon në kufizimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë specifikimet teknike të mësipërme, për sa i përket kontestimeve të ngritura nga ana e operatorit ekonomik ankimues dhe të marrë masa për modifikimin e specifikimeve kufizuese dhe përcaktuese, duke parashikuar alternativa, si dhe duke hapur diapazonin, por pa cenuar nivelin minimal të specifikimeve të kërkuara, ashtu sikurse parashikohet edhe në LPP, në funksion të hapjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.6 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*Infosoft Office*” SHPK mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit me arsyetimin se: “*Për artikullin nr. 51 AK ka kërkuar qese A4 me vrime anash, min 60 mic, prekje me kokrriza (pako me 100 fije), kërkesa që qesja të jetë me kokrriza është një kërkesë e ekzagjeruar dhe e panevojshme për funksionin e saj. Edhe një qese pa kokrriza, kryen të njëjtin funksion si ajo me kokrriza. Kërkojmë të hiqet kërkesa “prekje me kokrriza”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.6.1 Në dokumentet e tenderit, Shtojcën 5 “*Formulari i Specifikimeve Teknike*” autoriteti kontraktor ka parashikuar specifikimet teknike si vijon:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Binder Clips 15 mm (kuti me 12 copë).	kuti	100

2	<i>Binder Clips 19 mm (kuti me 12 copë).</i>	<i>kuti</i>	<i>100</i>
3	<i>Binder Clips 25 mm (kuti me 12 copë).</i>	<i>kuti</i>	<i>100</i>
4	<i>Binder Clips 32 mm (kuti me 12 copë).</i>	<i>kuti</i>	<i>100</i>
5	<i>Binder Clips 41 mm (kuti me 12 copë).</i>	<i>kuti</i>	<i>100</i>
6	<i>Binder Clips 51 mm (kuti me 12 copë).</i>	<i>kuti</i>	<i>100</i>
7	<i>Blloqe pune A5, minimumi 80 flet me vija.</i>	<i>copë</i>	<i>300</i>
8	<i>Bojë vule 30 ml blu.</i>	<i>copë</i>	<i>20</i>
9	<i>CD-RË 700 MB me kapak (pako me 10 copë).</i>	<i>pako</i>	<i>100</i>
10	<i>Dosje A4, me llastik , me karton të trashë min 450 gr.</i>	<i>copë</i>	<i>500</i>
11	<i>Dosje Bene plastike, me dy vrima, me kapëse, me kapak plastik 90 -110 mic.</i>	<i>copë</i>	<i>200</i>
12	<i>Dosje kartoni e plastifikuar A4, gjerësia min 3 cm, me llastik të gjerë min 1,2 cm.</i>	<i>copë</i>	<i>200</i>
13	<i>Dosje A4 me mekanizëm me kuti me përmasa 6x32x29 cm, e plastifikuar, kutia me kokrriza në prekje, me unaze për tërheqjen e dosjes.</i>	<i>copë</i>	<i>700</i>
14	<i>Dosje A4 me mekanizëm me kuti me përmasa 8x5x32x29 cm, e plastifikuar, kutia me kokrriza në prekje, me unaze për tërheqjen e dosjes.</i>	<i>copë</i>	<i>1300</i>
15	<i>Dosje me 20 qese plastike, kapak plastik i fortë, zarfi plastik duhet të jetë min 40 - 45 mic.</i>	<i>copë</i>	<i>100</i>
16	<i>Dosje me 30 qese plastike, kapak plastik i fortë, zarfi plastik duhet të jetë min 40 - 45 mic.</i>	<i>copë</i>	<i>200</i>
17	<i>Dosje Plastike me buton 35cm X 25cm me gjerësi 15cm, me unaze plastike per tërheqjen e dosjesh, me xhep per etikete.</i>	<i>copë</i>	<i>100</i>
18	<i>DVD me kapak.</i>	<i>copë</i>	<i>100</i>
19	<i>Evidenciator cilësor, me majë të pjerrët dhe me gjerësi min 5 mm, (pako me 4 cope).</i>	<i>pako</i>	<i>300</i>
20	<i>Flash Memory, 3.0, 32 GB.</i>	<i>copë</i>	<i>50</i>
21	<i>Flash Memory, 3.0, 64 GB.</i>	<i>copë</i>	<i>50</i>
22	<i>Gërshërë për letër min 21 cm, me doreza plastike.</i>	<i>copë</i>	<i>150</i>
23	<i>Goma për laps.</i>	<i>copë</i>	<i>300</i>
24	<i>Hapëse vrimash në letër min 25 fletë, me vizore dhe me kontenier për mbetjet e letrës.</i>	<i>copë</i>	<i>30</i>
25	<i>Hapëse vrimash në letër min 50 fletë, me vizore dhe me kontenier për mbetjet e letrës.</i>	<i>copë</i>	<i>10</i>
26	<i>Heqëse telash.</i>	<i>copë</i>	<i>200</i>
27	<i>Korrektor me shirit min 5 mm X 8 m.</i>	<i>copë</i>	<i>200</i>
28	<i>Korrektor stilo, me majë sferike metalike, me kapak, min 7 ml.</i>	<i>copë</i>	<i>400</i>
29	<i>Kuti kartoni arkive me kapak te përthyer me hapësirë te brendshme për dosje A4 përmasa e kutisë jo më pak se (L 40 x H 20 x D 29 cm)</i>	<i>copë</i>	<i>1500</i>
30	<i>Lapsa shënimesh i thjeshtë.</i>	<i>copë</i>	<i>1000</i>
31	<i>Letër A1 Rotolo Plotter 90 g/m2 e bardhë, me përmasa 914 cm x 50 m. Premium Quality.</i>	<i>rulon</i>	<i>25</i>
32	<i>Letër A4 80 g/m2 e bardhë (Kuti – 5 rizme) Premium Quality.</i>	<i>kuti</i>	<i>700</i>

33	Libër dorëzimi poste.	copë	50
34	Libër protokolli me 100 fletë.	copë	20
35	Makine stapler (qepje) dok. 23/10, me mekanizem metalik.	copë	5
36	Makine stapler (qepje) dok. 23/24, me mekanizem metalik.	copë	5
37	Makine stapler (qepje) dok. 24/6, me mekanizem metalik, min 18 cm, me dy mënyra kapje.	copë	200
38	Makinë llogaritëse tavoline me 12 shifra, ekran të lëvizshëm, me dy mënyra karikimi, të ketë të gjitha funksionet ekonomike.	copë	20
39	Marker permanent (pako me 4 copë)	pako	100
40	Mbajtëse dokumentash horizontale me tre kate metalike per tavolin	copë	200
41	Mina, me përmasa 0.5 mm, 12 pcs HB.	copë	100
42	Mina, me përmasa 0.7 mm, 12 pcs HB.	copë	100
43	Ngjitës stik, me peshë min 20 gr.	copë	100
44	Notes, me përmasa 125 mm x 75 mm, pesha min 75 gr, me 100 fletë pakoja.	copë	500
45	Notes, me përmasa 45 mm x 12 mm, me 100 fletë, plastike me shumë ngjyra.	copë	500
46	Notes, me përmasa 76 mm x 76mm, pesha min 75 gr, me 100 fletë pakoja.	copë	500
47	Paper Clip 33 mm (pako me 100 copë).	pako	500
48	Paper Clip 50 mm (pako me 100 copë).	pako	200
49	Portamina me majë 0.5 mm, me gominë në mbajtësen e lapsit, turp plastik, me gomë	copë	100
50	Portamina me majë 0.7 mm, me gominë në mbajtësen e lapsit, turp plastik, me gomë	copë	200
51	Qese A4 me vrima anash, min 60 mic, prekje me kokrriza (pako me 100 fije).	pako	600
52	Skoc ngjitës i tejdukshëm, me përmasa min 15 x 10.	copë	200
53	Skoc ngjitës i tejdukshëm, për ambalazh.	copë	50
